



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 171/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, për shkak të mbulimit të posterit, për Zgjedhjet e Lokale për Kryetar të Komunës së Mitrovicës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5150 (pesëmijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 06.10.2013, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se PDK ka thyer rregullat e zgjedhore ku me dt. 05 tetor 2013 rreth orës 23:00 në rrugën "Mbretëresha Teutë" anëtarë të këtij subjekti kanë vendosur material zgjedhor (njoftim) në të njëjtin vend ku kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune të Mitrovicës, nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës fotografën nga vendi i ngjarjes si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, më datë 06.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.171/2, PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK lidhur me ankesën Anr 171, të paraqitur nga subjekti politik LVV, ku në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK në të cilën theksohet se pretendimet e LVV janë të trilluara dhe konsiderojmë se janë të pabazuara lidhur me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes dhe LZP-së. PDK shtoi se të gjitha dëshmitë e LVV janë të natyrës së njëjta, dhe për këtë fakt nuk duhet të merren parasysh.

Asnjë veprim i tillë nuk është bërë nga aktivistët e PDK-së dhe se për këto veprime nuk mbajmë përgjegjësi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizo shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet ankimore se subjekti politik PDK, ka vendosur material zgjedhor mbi posterin e kandidatit për kryetar komune në Mitrovicë nga radhet e LVV-së, janë të bazuara, siç identifikohet çart nga fotografia e ofruar si dëshmi, veprim i cili është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe nenit 4.1 pika a) Rregullës Zgjedhore 11/2013 që parasheh veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, heqjen, mbulimin, dëmtimin ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e subjektit tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Pretendimet në përgjigje të ankesës nga ana e subjektit politik PDK se kjo shkelje nuk është bërë nga aktivistët e këtij subjekti politik siç pretendohet në ankesë dhe për këtë theksojnë në përgjigje të ankesës se nuk mbajnë përgjegjësi për një veprim të tillë, pretendimet e potencuara në përgjigje të ankesës nuk qendrojnë ngase më nenin 32.2 dhe 6 të LZP-së parashihen përgjegjësit e subjektit politik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP- konstatoi nga dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik PDK ka shkelur neni 33 pika a) i LZP-së dhe neni 4.1 pika b) i Rregullës Zgjedhore 11/2013, ngase nga fotografia e ofruar si dëshmi që gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se është mbuluar posterin e kandidatit për Kryetar të Komunës të Mitrovicës nga radhët e LVV, me materialin zgjedhor të subjektit politik PDK. Prandaj nga të gjitha arsyet e lartshënuara si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së dhe nenit 3.1 të Rregullës nr.1 “Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave” të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

Anr. 171/2013 më datën 09.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*